



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 266, Datë 10.12.2024

MBI

**MIRATIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË TREGTIMIT PËR TREGUN E ANKANDEVE
BRENDA SË NJËJTËS DITË NË BURSËN SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 18 pika 1, gërma “a” dhe “dh”; 19 gërma “a”, 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar si dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016; VKM-së nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, e ndryshuar, si dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2393/3 prot., datë 06.12.2024, i përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit për tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, bordi i ERE-s vendosi të miratojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, ndërsa me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.03.2023, janë miratuar disa shtesa në rregullat e tregut të energjisë elektrike, konkretisht anekset nr. 1 deri në 7.
- ALPEX me shkresën nr. 421 prot., datë 20.11.2024, protokolluar ne ERE me nr. 2393/2 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur propozimin e saj mbi ditën e fillimit të tregtimit për Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (Ankandi CRIDA-1).
- ALPEX, në bashkëpunim me OST dhe KOSTT, ka përfunduar me sukses testet teknike të nevojshme për të garantuar funksionimin e Platformave të Tregtimit dhe integrimin e tyre: Testet FiT (Functionality Integration Test) për CRIDA-t, të kryera nga data 25.07.2024 deri më 09.08.2024 si dhe Testet SiT (Simulation Integration Test), të zhvilluara nga data 13.08.2024 deri më 21.08.2024. Përfundimi me sukses i këtyre testeve konfirmon gatishmërinë teknike të Platformave të Tregtimit, Klerimit dhe Skedulimit.

- ALPEX ka anëtarësuar 23 Anëtarë Burse për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 12 Anëtarë Burse për Zonën e Ofertimit të Kosovës. Prej këtyre: 11 Anëtarë nga Zona e Ofertimit të Shqipërisë dhe 7 Anëtarë nga Zona e Ofertimit të Kosovës janë regjistruar për të marrë pjesë në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë.
- ALPEX ka trajnuar dhe certifikuar Agjentët Tregtarë dhe Agjentët Klerues, duke siguruar një funksionim normal dhe të qëndrueshëm të tregut.
- Platforma e Tregtimit (ETSS), Klerimit dhe Menaxhimit të Riskut (EMCS) është përgatitur dhe funksionon në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE. Kjo platformë mbështet integrimin dhe nisjen e Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë.
- Rezulton se Drejtoritë Teknike dhe shoqëria ALPEX sh.a., kanë vlerësuar se kërkesat e nevojshme për fillimin e tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë janë përmbushur dhe janë në përputhje me paragrafin K.1.3.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, ku citohet: "E para Njësi Kohore e Tregut për qëllim të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike do të fillojë në Kohën e Përcaktuar."
- Shoqëria ALPEX sh.a. ka propozuar që dita e fillimit të Tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë të jetë Njësi Kohore e Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.12.2024, që i korrespondon Ankandit CRIDA-1.
- Për sa më sipër Shoqëria ALPEX sh.a. ka përmbushur të gjitha kërkesat për fillimin e operimit të Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë, bazuar në gatishmërinë e platformave teknike, përfundimin me sukses të testeve të integritetit, trajnimin dhe certifikimin e agjentëve tregtarë, si dhe organizimin e workshop-eve për aftësimin e pjesëmarrësve të tregut.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Njësisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.12.2024, si dita e fillimit të tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.
2. Shoqëria ALPEX sh.a. duhet të njoftojë ERE-n, anëtarët e Bursës Shqiptare të Energjisë si dhe palët e interesuara mbi funksionimin e ankandit CRIDA-2, jo më vonë se 48 orë përpara fillimit të operimit të tij.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike - Alpex sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e tjera të interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI